

Nr.regj. 33960/2010

2

REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDER KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	
Dep.	
Dep.	D-P
Nr. i faq.	
Broj stranica	
Nr. pages	
Nr Prot	
Br Prot	
Prot No	03-4469/11
Data	
Datum	14.11.2011
Date	

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË, duke vendosur në procedurën për kundërvajtje kundër të pandehurit Liridon Restelica nga Prishtina, për kundërvajtje nga neni 7 paragrafi 1 e ndëshkuar me nenin 16 paragrafi 1 pika 2 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave të Zyrtarëve të lartë Publik e Pasurisë, Nr. 03/L-151, në bazë të nenit 73,74, 195,199 të Ligjit mbi Kundërvajtjet GZ KSAK 23/79, me datë **10.10.2011** merr këtë:

AKTVE N D I M

I PANDEHURI: Liridon Isak Restelica, i lindur më 19.10.1984 në Prishtinë, ku edhe tani jeton, lagja "Nici" në Çagllavicë, magjistër, Deputet në Kuvendin Komunal në Prishtinë, i pamartuar, i gjendjes së mesme ekonomike,

Ë s h t ë P ë r g j e g j ë s

Sepse, pas marrjes së detyrës si Këshilltar Politik në Ministrinë e Energjisë dhe Minierave me datë 01.07.2010, nuk e ka deklaruar gjendjen e pasurisë në Agjencinë Kundër Korrupsionit, brenda afatit ligjor prej 60 ditësh,

- me çka ka kryer kundërvajtje nga neni 7 paragrafi 1 e ndëshkuar me nenin 16 paragrafi 1 pika 2 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave të Zyrtarëve të lartë Publik, andaj të pandehurit për këtë kundërvajtje i shqiptohet,

D Ë N I M I

Me gjobë në shumë prej 200 € (dyqind euro), të cilën shumë i pandehuri është i obliguar ta paguaj në afat prej 15 ditësh, pasi që ky aktvendim të merr formë e prerë, në llogarinë e të hyrave gjyqësore të KGJK-së No.1000 4300 7000 0518. Pagesa bëhet në ndonjërin agjenci për mbledhjen e të hyrave-bankë, përmes urdhërpagesës së plotësuar nga Gjykata. Nëse gjobën e shqiptuar nuk e paguan në afatin e dhënë, e njëjta do të zëvendësohet me dënim burgimi në kohëzgjatje prej **13 ditësh**, duke llogaritur nga 15 Euro për një ditë burgimi.

Shpenzime të procedurës nuk ka pasur, kurse në emër të paushallit gjyqësor i pandehuri është i obliguar të paguaj shumë prej **5 Euro** në shërbimin e arkës së gjykatës.

Nga një kopje e këtij aktvendimi i dërgohet parashtruesit të kërkesës dhe të pandehurit

A r s y t i m

Agjencia Kundër Korrupsionit në Prishtinë (AKK), i parashtrori kësaj gjykate Kërkesën 01/3499/2010 me datë 26.10.2010 për fillimin e procedurës kundërvajtëse ndaj të pandehurit të lartshënuar për kundërvajtjen e precizuar si në dispozitiv të këtij aktvendimi, meqë i njëjti nuk e ka dorëzuar në Agjencinë Kundër Korrupsionit formularin mbi deklarimin e gjendjes së pasurisë brenda afatit ligjor prej 60 ditësh nga marrja e detyrës.

Në bazë të kërkesës së parashtruar, gjyqtarja filloi procedurën kundërvajtëse, mori në pyetje të pandehurin i cili në mbrojtjen e vet deklaroi se e kundërshton kundërvajtjen e cila i vihet në barrë me kërkesë, për faktin se nuk ka qenë i njoftuar se duhet të deklarojë gjendjen e pasurisë me rastin e marrjes së detyrës dhe as për faktin se është i përfshirë në listën e zyrtarëve të lartë në MEM. Në vazhdim i pandehuri shton se 2-3 ditë pas marrjes së detyrës ka kontaktuar me një zyrtar nga AKK me qëllim që të informohet për çështjen e deklarimit të pasurisë dhe se ai zyrtari të cilit emrin nuk ia din i paska thënë se nuk është

obligative të bëjë deklarin e pasurisë deri në fillim të vitit të ardhshëm, duke aluduar për deklarin e rregullt deri më 31.03.2011.

Për vërtetim të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, gjyqtarja dëgjoi edhe parashtruesin e kërkesës, zyrtarin përkatës nga AKK, z.Atashi, i cili është person kompetent për informim të zyrtarëve që janë të caktuar si pika kontaktuese nëpër institucione gjegjëse, e i cili deklaroi se nga mesi i muajit korrik nëpërmjet postës elektronike ka kërkuar nga zyrtarja përkatëse në MEM që brenda afatit 15 ditor të njoftojë Agjencinë për fillimin apo përfundimin e punës së zyrtarëve të lartë publik në institucion. Në vazhdim zyrtari i AKK deklaroi se ai nuk ka biseduar fare me të pandehurin, përndryshe asnjëherë as ai e as ndonjë nga tre zyrtarët kompetent në divizionin për antikorrupsion nuk do ti kishte dhënë informata të shtrembëruara as të pandehurit e as kujdo qoftë tjetër.

Në vazhdim për vërtetim sa më të plotë të gjendjes faktike, gjyqtarja dëgjoi edhe zyrtaren përkatëse nga MEM e cila prezantoi ca korrespondenca si prova shtesë, dhe deklaroi se i pandehuri është emëruar me datë 01.07.2010 si këshilltar politik, se vërtetë me kërkesë të zyrtarit të AKK, ia ka dërguar AKK listën shtesë me shënime për zyrtarët e lartë në MEM, si përgjigje me datë 16.07.2011, por siç thotë kërkesës i ka munguar instruksioni i saktë si të veprjës.

Nga të dhënat në kërkesë, vlerësimi i deklaratës së të pandehurit, të parashtruesit të kërkesës dhe zyrtares së MEM, të dy në cilësi të dëshmitarëve, shqyrtimi i shkresave të tjera të lëndës dhe pas administrimit të provave shtesë dhe gjitha së bashku, gjyqtarja nuk ia fali besimin deklaratës së të pandehurit, ngase i njëjti nuk arriti të dëshmojë se cili është zyrtari i AKK i cili i paska thënë se nuk ka obligim të deklaroj pasurinë me rastin e marrjes së detyrës dhe se këtë mund ta bëjë me deklarin të rregullt në vitin vijues. Fakti i kontaktimit të të pandehurit me një zyrtar nga AKK e përjashton edhe mundësinë e të qenunit i pa informuar, ngase i njëjti ka pasur njohuri lidhur me deklarin e pasurisë, e nga ana tjetër botërisht ka qenë e njohur çështja e deklarin të pasurisë dhe format e saj nëpërmjet medimeve dhe web faqes së AKK. Andaj, gjyqtarja në masë të mjaftueshme vërtetoi gjendjen e plotë faktike, ekzistimin e veprës kundërvajtëse dhe përgjegjësisë së të pandehurit për këtë kundërvajtje dhe të njëjtin e dënoi me gjobën e paraparë ligjore.

Gjatë shqiptimit të dënimit gjyqtarja pati parasysh rrethanat nga neni 7 i LK në të cilat është kryer kundërvajtja dhe duke vlerësuar masën e shkeljes sipas pozitës së zyrtarit të lartë publik si dhe personalitetin e tij, të njëjtit ia shqiptoi dënimin me gjobë të precizuar si në dispozitiv, me bindje se edhe me një gjobë të tillë do të arrihet qëllimi i ndëshkimit dhe se i pandehuri në të ardhmen do të shmanget nga kryerja e ndonjë kundërvajtjeje të tillë apo të ngjashme.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

U VENDOS NË GJYKATËN KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË
Nr.regj.33960/2010, datë 10.10.2011

Gjyqtarja
Suzana Cerikni

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 8 ditësh Gjykatës së Lartë për Kundërvajtje në Prishtinë, nga data e pranimit të njëjtit nëpër njëri prej kësaj gjykate, pa taksa.

